

**VENDIM**  
**Nr.764, datë 2.11.2011**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NR.1056, DATË 16.7.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN QENDËR BILISHT TË QARKUT TË KORÇËS” DHE NR.560, DATË 7.5.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA QENDËR BILISHT TË QARKUT TË KORÇËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme të tipit, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Qendër Bilisht. Lista është me 1 (një) fletë e përfundon me numrin rendor 26 (njëzet e gjashtë).

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të tipit, pyje dhe kullota, që i transferohen në pronësi komunës Qendër Bilisht. Lista është me 1 (një) fletë e përfundon me numrin rendor 26 (njëzet e gjashtë).

3. Lista shtesë e inventarit, lista shtesë e pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi të komunës, si dhe tabela me lidhjen numër 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësia e qeverisjes vendore, Qendër Bilisht, të qarkut të Korçës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**